



RREGULLORE E PRANIMIT TË STUDENTËVE NË PROGRAMIN E STUDIMIT "BACHELOR" NË EDUKIM FIZIK DHE SPORTE PËR VITIN AKADEMIK 2017–2018

1. Të drejtën për të konkurruar e gëzojnë të gjithë nxënësit që janë diplomuar në arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe në arsimin e mesëm profesional sportiv ose jo sportiv, të cilët kanë përfunduar konform rregullores së MAS, detyrimetë Maturës Shtetërore në vitin akademik 2016 – 2017.
2. Mbështetur në VKM Nr. 346 dt. 19.04.2017, kanë të drejtë të regjistrohen për të konkurruar të gjithë kandidatët që kanë përfunduar nivelin e arsimit të mesëm me notë mesatare 6 (gjashtë) e lart.
3. Data e konkurrimit si dhe kuota e pranimit, përcaktohen nga Universiteti "A. Xhuvani".
4. Rregulloren e konkurrimit, Normat e pranimit, në programin e studimit "Bachelor" në edukim fizik dhe sporte si dhe Skedën Shëndetësore Individuale, të interesuarit mund ta gjejnë në faqen zyrtare të Universitetit "A.Xhuvani", www.uniel.edu.al. Gjithashtu një kopje do e tërheqin në sekretarinë e Fakultetit të Shkencave të Edukimit, në momentin e regjistrimit për konkurrim. Bashkëngjitur do të gjeni skedën e kontrollit shëndetësor dhe datën e caktuar për fillimin e regjistrimit për konkurrim, si dhe datën e zhvillimit të konkursit.
5. Konkurruesit që rezultojnë me probleme të shëndetit, humbasin të drejtën e përfshirjes në konkurrim.
6. Njoftimi për datën, orën dhe vendin e organizimit të konkurrimit, shpallet dy javë para datës së konkurrimit. Njoftimi shpallet në median vizive e të shkruar. Ju mund ta kërkonit atë edhe në adresën e internetit të UE, www.uniel.edu.al
7. Konkurruesit të paraqiten në konkurrim me uniformë sportive.
8. Dokumentat e vlefshme për regjistrim janë:
 - Dokument personal identifikimi me fotografi.(Kartë identitetië fotokopje e saj,ose Pasaporte dhe fotokopje e saj).
 - Skeda shëndetësore e dhënë nga institucioni,e cila vërteton gjendjen shëndetësore të konkuruesit në përballimin e sforcimeve fizike,e plotësuar nga mjekë të specialitetit në rrethin ku i interesuari banon.
 - Dy fotografi.
 - Mandat arkëtimi i tarifës së regjistrimit.
9. Konkurruesi përfiton 60% të pikëve nga konkurrimi sportiv dhe 40% të pikëve nga rezultati i maturës shtetërore.
10. Rezultati shumë i mirë vetëm në një disiplinë sportive ndikon, por jo domosdoshmërisht vendos për suksesin e konkuruesit.
11. Numri maksimal i pikëve në konkursin praktik është 70 pike:
 - Atletikë 18 pikë (6 pikë vrapimi 100 m, 6 pikë vrapimi 800 m dhe 6 pikë kërcimi nga vendi.
 - Gjimnastikë 17 pikë (9 pikë akrobaci dhe 8 pikë kërcim kaluçi)
 - Basketboll 18 pikë (9 pikë cirkuidi dhe 9 pikë gjuajtje të lira)
 - Volejball 17 pikë (9 pikë shërbimet dhe 9 pikë pasimet)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN
FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT
DEPARTAMENTI I EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTEVE

12. Sasia e pikëve të grumbulluara nga konkurruesi në 4 disiplinat sportive: Atletikë, Gjymnastikë, Volejboll, Basketboll, si rregull mbledhen me pikët e përftuara nga matura shtetërore. Shuma e këtyre pikëve do të përbëjë rezultatin përfundimtar të pikëve që grumbullon çdo konkurrues.

PERGJEGJESI I DEPARTAMENTIT
PhD.Doc. Edmond BIÇOKU

DEKANI
Prof.as.dr.Valentina HAXHIYMERI